

RAORTI I PERMBLEDHUR I  
VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE  
MJEDIS PRODHIM BETONI DHE  
SEGMENTE BETONI

# IMPIANT PRODHIM BETONI DHE SEGMENTE BETONI

Sipas ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011,  
Shtojca 1, te gjitha instalimet leje tipi  
B Industria minerare, pika 3.1.e, Perzierja e  
çimentos ose perdorimi i çimentos

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u  
përgatit Nga STUDIOPROJEKT SH.P.K  
K62021001S per Kompanine Limak Age Jv  
L32002006H Kontraktorin e Punimeve Civile per  
Hydrocentralin e Banjes dhe te Moglices te Projektit  
Devoll Hydropower

EKSPERT MJEDISI : XHEVAIR DERMYSHI

## 1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Ky raport i vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte hartuar per nje nga komponentet perberes te punimeve civile per realizimin e vepres Hec Moglice konkretisht per “Impianteve te prodhimit te betonit ,segmenteve te betonit dhe Impiant thyerje fraksionim inertesh ” . Shoqeria Devoll Hydropower eshte pajisur me leje mjedisore per Ndertimin dhe Funksonimin e Hidrocentraleve (H/C)te kaskades se Devollit .Kjo leje nuk perjashton detyrimin per vleresimin e ndkimeve ne mjedis dhe pajisjen me leje mjedisore per projekte te vecanta . Vleresimi i ndikimit ne Mjedis (VNM) eshte nje studim i cili ka per qellim percaktimin e impakteve mjedisore qe do te kete projekti ne mjedisin toke, uje, ajer si dhe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis.Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marr ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.Ndikimi, efekti i nje projekti qe ka ne mjedisin rrethues, vleresimi, analiza qe i behet ketij projekti Mjedis, elementet abiotike dhe biotike.VNM gjithashtu perfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese, reduktuese dhe eliminuese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet:

- ♦ Marrjes ne konsiderate te ceshtjeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- ♦ Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- ♦ Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit dhe impaktit ne mjedis nga aktiviteti qe do zhvillohet
- ♦ Analizimin e faktoreve pozitive dhe negative mjedisore, marrjen e masave zbutese, reduktuese dhe eliminuese per ndikimet negative.
- ♦ Nxjerrjes ne dukje dhe vleresim cilesor i ndikimeve ne mjedis te projektit.
- ♦ Propozime dhe rekomandime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Studimi percakton detyrat dhe mjetet e nevojshme per arritjen e misionit dhe objektive ne jeten e komunitetit.Gjithashtu nje synim tjetër eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit. Me qellim qe te minimizohen ndikimet e pafavorshme afat-shkurter dhe afat-gjate mbi mjedisin .


### 1.1 Devoll Hydropower

Statkraft AS, kompani Norvegjeze, lider në Europë për energjinë e rinovueshme Në datën 19 Dhjetor, 2008 në Tiranë, sipërmarrjes së përbashkët iu dha e drejta për të zhvilluar projektet hidroenergjetike në Lumin Devoll në Shqipëri, nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes së Koncesionit me Qeverinë Shqiptare Në bazë të MK, e cila hyri në fuqi në datën 1 Prill 2009, DHP i jepet Konçesioni i tipit Ndërto, Zotëro, Shfrytëzo & Transfero për zhvillimin dhe shfrytëzimin e potencialit

hidroenergetik në Lumin Devoll.

Zona e Koncesionit ndodhet afërsisht 70 km në jug të qytetit të Tiranës dhe përfshin rajonin malor të shtrirjes së mesme dhe të sipërme të lumit Devoll midis qytetit të Maliqit dhe fshatit të Banjës. Zona e projektit, siç përcaktohet dhe në Marrëveshjen e Koncesionit, përfshin të gjithë Luginën e Devollit midis Maliqit, e cila ndodhet në kufi me pllajën e Korçës, dhe fshatin e Banjës i cili ndodhet afërsisht 40 km në jug të qytetit të Tiranës.

Nga pikëpamja topografike, zona e drejtpërdrejtë ujëmbledhëse e lumit Devoll mbulon pllajën e Korçës, shtrirjen malore të mesme të lumenjve Devoll dhe Tomoricë deri në Gramsh dhe fshatrat kodrinor të valëzuar nga Gramshi deri poshtë në Kozarë. Në Kozarë në Rrethin e Kuçovës, Lumi Devoll bashkohet me Lumin Osum dhe quhet Lumi Seman siç tregohet në Figurën e mëposhtme



## ZHVILLIMI I HIDROCENTRALIT TË DEVOLLIT

### 1.1.1 Hidrocentrali i Moglicës Struktura dhe Karakteristikat Kryesore


Hidrocentrali i Moglicës shfrytëzon një burim 300 metra midis lartësisë 650 dhe 350 metra mbi nivelin e detit dhe do të funksionojë si impiant me ngarkesë maksimale, sipas nevojës. Struktura e tij, me vendndodhjen e ambienteve të ndërtimit si galeri hyrëse, kanale depozitash për mbetjen e dheut, gurore, pajisje dhe kampi, tregohen në Figurën e mëposhtme. Me anë të formimit të kanalit ujësjellës (me vijë bojëqielli të ndërprerë) nga diga për në stacionin elektrik në rrjedhën e sipërme të bashkërrjedhjes së degës Grabovë, Lumi Devoll do të zbrazet nga uji përgjatë një zgjatimi prej 12 km.

Komponentët kryesorë të projektit janë:

- Diga e Moglicës, përbën një digë rreth 150 metra të lartë, me bazament asfalti të papërshkueshëm nga uji. Niveli më i lartë i Rregulluar i Ujit është 650 metra mbi nivelin e detit, duke krijuar një liqen me një sipërfaqe prej 7.2 km<sup>2</sup>. Kanali i shkarkimit ka 3 porta. Rezervuari i digës ka një volum nën nivelin më të lartë të kontrollueshëm rreth 152 Mm<sup>3</sup> dhe volum nën nivel më të ulët të kontrollueshëm rreth 210 Mm<sup>3</sup>. Diga ka kanale devijimi dhe shkarkimi në dy nivele.
- Thellësia e hyrjes është 610 metra mbi nivelin e detit.
- Mekanizmi i marrjes së energjisë me rrjetë mbrojtëse dhe portë rrotulluese.
- Kanali ujësjellës që përbën një tunel 11,000 metra të gjatë, me tre galeri hyrëse ndërtimi.
- Rezervuar nivelimi në kanalën ujësjellës në formën e një tuneli të pjerrët rreth 736 metra.
- Dy kanale shkarkimi çeliku të vendosur nën tokë me gjatësi 44 metra dhe 58 metra.
- Central elektrik i nëndheshëm me tunele hyrëse dhe kanale ndihmëse.
- Një kanal shkarkimi rreth 745 metra i gjatë që çon në rezervuarin e krijuar nga Diga Kokël në Lumin Devoll.

Centrali elektrik ka dy turbina radiale me kapacitet të përgjithshëm prej 171.2 MW. Voltazhi i transmetimit është 220 kV dhe prodhimi mesatar vjetor i llogaritur i energjisë është 445-448 GWh, në varësi të operacioneve të shkarkimit. Rruga ekzistuese deri në luginë (vija me ngjyrë rozë) do të përmirësohet siç kërkohet për impiantin e ndërtimit për të hyrë në sheshet e ndërtimit dhe për transportimin e komponentëve të centralit elektrik.

Nga ana e Shtetit Shqiptar do të krijohet akses lokal në ambientet e sheshit të ndërtimit (vija me ngjyrë të verdhë). Linja e transmetimit nga stacioni elektrik i Moglicës, është sugjeruar të jete rreth e rrotull pjesës veri-lindore të luginës, siç paraqitet në Figurën e mëposhtme



Projekti Hidroenergjetik i Devollit është aktualisht një nga investimet më të mëdha hidroenergjetike në Ballkan dhe investimi i parë në shkallë të gjerë Partneritet-Publik-Privat në Shqipëri.

### 1.1.2 projekti hidroenergjetik i devollit zhvillohet nën mekanizmin e zhvillimit të pastër

MZhP është mekanizmi i Protokollit të Kiotos për të mbështetur vendet në zhvillim në reduktimin e emetimeve të gazrave serrë duke mbështetur zhvillimin e prodhimit të energjive të rinovueshme. MZhP do të thotë:

- Mbështetje e projekteve që ndihmojnë parandalimin e ndryshimeve klimatike
- Prodhim i energjisë së “Gjelbër”
- Më pak CO<sub>2</sub> në prodhimin e energjisë
- Zbatim i rregullave ekologjike dhe sociale vendore
- Projekti MZhP certifikohet nga një ent i pavarur (palë e tretë)
- Projekti MZhP duhet të regjistrohet nga UNFCCC

- Projekti MZhp duhet miratuar nga Autoriteti i Përcaktuar Shqiptar
- MZhp në Projektin Hidroenergetik të Devollit siguron pajtimin me rregullat ndërkombëtare dhe kombëta re dhe me standardet e qëndrueshmërisë.

## 2 LEJE INFRASTRUKTURE E NDERTIMIT TE HIDROCENTRALEVE

Vendimi Nr 1 date 20.12.2012

Ne Projekt Ndertimin jane te perfshira dhe ndertimet e godinave te sherbimit ne funksjon te ndertimit te heceve .Plan vendosjen e godinave mund ta gjeni ne vijim .



  
**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**  
**SOKOL OLLDASHI**  
MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT



**SEKRETARE E KKT**

**KREUZA LEKA**  
DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT



 <b>REPUBLIKA E SHQIPËRISË</b> Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës		<b>LEJE</b>	
Nr. 2369-10-2011 Kodi: 41.1.B Data e miratimit: 18/03/2012 Ades / vlerësimi: Po shpirt	<b>DEVOLL HYDROPOWER</b> NUTS/NUT: K0241002C Tërësi: TIRANË, Tërësi: TIRANË, Rrugë Pajë (Gjati Palli) 8-10, NNA	Emërtimi përshkrimi i veprimtarisë Leje rekonstruksion për Projektin hidroenergjetik të Devollit	
Kategoritë Për ndërtimin në rregull	Kodi i shtetit		
Kategoritë Leje rekonstruksion	Përfundimi i veprimtarisë Leje rekonstruksion sipas rregullorës së veprimtarisë në fuqi		
Veprimtari specifike	Detajet e veprimtarisë 1. Qëni bashkëkoncesionar për secën subjekt. Leje rekonstruksion sipas rregullorës së veprimtarisë në fuqi		
Specifikimi	Tërësi / Ekipimi i veprimtarisë Mirëmbajtja e furnit Devoll		
Numërimi i qortetit: <i>004/10</i> <i>Gjy.B. nr. 6</i>			

Miratimi i Kontrates Koncesionare



## FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.28**

**17 mars**

**2009**

### PËRMBAJTJA

Ligj nr. 10 083  
datë 23.2.2009

Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe AVN AG, Statkraft AS dhe Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumën Devoll në Republikën e Shqipërisë .....

Faqe

1593

### 2.1.1 PUNIMET CIVILE

Me date 01.07.2013 - Devoll Hydropower Sh.A. ka nënshkruar kontratën e Punimeve Civile me Limak-AGE Joint Venture. Kontrata përfshin punimet civile për hidrocentralet e Banjës dhe Moglicës. Punimet priten të fillojnë në fund të vitit 2013 dhe të përfundojnë më 2019.

### 2.2 SHOQERIA LIMAK AGE JV DEGE E SHOQERISE SE HUAJ



Shoqëria Limak është formuar në vitin 1976 në Turqi, ushtron aktivitet në fushën e Ndertimit, Turizmit, Infrastruktura, Buqësi dhe Belgjori, Menaxhim portesh dhe aeroportesh, prodhim cimento etj. Ndertim centrale hidroelektike, diga, aeroporte, porte detare, vepra gazsjellesi, hotele turistike, godina banimi, rruge, ura dhe vepra të ndryshme inxhinjerie brenda dhe jashtë vendit. Në Shqipëri është formuar në datën 28/08/2013 me numër nipt L32002006H do të realizojë punimet civile për ndertimin e Hec Banje dhe Hec Moglice. Kontrata e Punimeve Civile e nënshkruar me Limak-AGE Joint Venture, është një prej disakontratave që Devoll Hydropower Sh.A. ka nënshkruar me qëllim të zbatimit të këtij projekti madhor hidroenergetik në Shqipëri.

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË,  
TREGTISË DHE ENERJITIKËS  
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

OKR  
National Center of Registration

NUMRI SERIAL:  
SN-202438-10-13

**ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI**

Personit të tatueshëm:  
LIMAK INSAAT SANAYI ve TICARET ANONIM SIRKETI AGE INSAAT ve TICARET ANONIM SIRKETI ADI ORTAKLIGI – Degë e Shoqërisë së Huaj

Statusi:  
Aktiv

Me adresë kryesore:  
Tirane, Tirane, Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Katë 13.

I jepet ky numër identifikimi (NUIS):  
L32002006H

Afati i veprimtarisë:  
Nga: 28/07/2013 deri

DATA E REGJISTRIMIT  
02/08/2013

DATA E LËSHIMIT  
14-10-2013

SPORTELI I SHËRBIMIT:

QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

Kjo çertifikatë mbahet pranë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaje.  
Kjo çertifikatë duhet mbajtur në ndeshje të përfunduar.

### 2.2.1 Çertifikatë Regjistrimi Limak Age Jv

Numri unik i identifikimit të subjektit (NIPT)	L32002006H
Data e Regjistrimit	02/08/2013

Emri i Subjektit	LIMAK INSAAT SANAYI ve TICARET ANONIM SIRKETI AGE INSAAT ve TICARET ANONIM SIRKETI ADI ORTAKLIGI
Forma ligjore	Dege e shoqërisë së huaj
Selia	Tirane Tirane TIRANE Rruga Abdi Toptani, Torre Drin, Kati 13.

000837



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS  
 Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licensave Profesionale për Shoqëritë që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtuese Zbatimi

**L I C E N C E**  
**NZ.6988/4**

**SHOQERIA:** "LIMAK INSAAT ve TICARET ANONIM SIRKETI  
 AGE ANSAAT ve TICARET ANONIM SIRKETI  
 ADI ARTAKLIGI (Dege e Shoqerise se Huaj)"

**DREJTUES LIGJOR:** NIHAT OZDEMIR YAVUZ DIKER  
 ATILLA ONEN MUSTAFA OZCAN  
 SEZAI BACAŞIZ

**DREJTUES TEKNIK:** TANER BOZKURT; OZER YILMAZ; NAZAN GUNHAN,  
 CAHIT BARUT; MURAT SUZAL; MITHAT KOCAERKEK  
 YAVUZ DIKER, ATILLA ONEN; S EZAI AZIZOGLU,  
 ULVI BAHTIYAR; HYSEIN ARSLANOGLU; SELCUK YENIKAJA

**REZIDENCA:** TIRANË

Regjistruar ne Regjistrin themeltar qe nga data: **04.08.2014**

Kategori	Klasifikim	Emertimi i kategorise
NP-1	A	Punime gërmimi në tokë.
NP-2	A	Ndërtime civile dhe industriale.
NP-3	A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
NP-4	F	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
NP-5	A	Punime nëntoksore, ura e vepra arti.
NP-6	E	Diga dhe tunele hidroteknike.
NP-7	A	Ujshjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.
NP-9	A	Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime.
NP-11	A	Ndërtime për N/stac., kab. e transform. linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
NP-12	A	Punime të inxhinierise se mjedisit.
NS-1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve.
NS-2	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
NS-3	A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë levizëse, transportues).
NS-4	A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metaik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
NS-5	A	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.
NS-6	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
NS-7	A	Barriera dhe mbrojtje rrugore.
NS-12	A	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
NS-13	A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
NS-14	A	Impiante të brendëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
NS-16	A	Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.
NS-17	A	Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.
NS-18	A	Punime topogjeodezike.
NS-19	A	Sistemet kundra zhurmës për infrastructure.

**KRYETARJA E KOMISIONIT**

**GERTA LUBONJA**

Shenim: Kjo licence lëshohet deri ne datën 02.12.2016.



Licenca e Shoqerise Limak Age Jv

INFORMACIONI MBI PERSONIN E KONTAKTIT TË AUTORIZUAR  
NGA ADMINISTRATORI NË LIDHJE ME LEJEN

Emri dhe Mbiemri	Helena Metka
Adresa	Rr.Abdi Toptani
Telefoni	00355-67-60-72-038
E-mail	<a href="mailto:hmetka@limak.com.tr">hmetka@limak.com.tr</a>

Pershkrimi i Projektit

IMPIANT PRODHIM BETONI DHE SEGMENTE BETONI

**Impjanti i prodhimit te betonit perbehet nga keto makineri dhe paisje:**

- Tanker i inerteve dhe cimentos.
- Bunkerat, sillosat.
- Transportiere.
- Paisjet e dozimit.
- Paisjet e komandimit automatik.
- Vend Parkimi i Betoniereve dhe Pompave te betonit
- Vend depozitimi i lendes se pare (planvendosja )
- Vaska dekantuese

**Procesi teknologjik**

Pershkrimi i procesit teknologjik te prodhimit te betonit:

Materjali i thyer dhe i fraksionuar depozitohet ne bunkerin e lende se pare, prej ku dozohet ne menyre automatike se bashku me cimenton dhe transportohen per t'u perzjere edhe me uje dhe aditive te ndryshem per prodhimin e betonit ne perputhje me markat e betonit te kerkuara. Procesi i dozimit dhe transportimit shoqerohet me sperkatje me uje me qellim te evitimit te pluhurave ne mjedisin rrethues. Ky uje nepermjet sistemit te tubacioneve shkon ne impjantin e prodhimit te betonit

**IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS TE AKTIVITETIT**

Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

**Ndikimet e pritshme ne mjedis**

Ndikimet e analizuara gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbledhen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

**Lenda djegese**

Procesi nuk perdor lende djegese. Vetem perdorin mjetet e ngarkim-shkarkimit sipas normativave dhe kohes se punes, e cila eshte 6 dite ne jave vetem me nje nderrese.

### **Uje industrial**

Qe perdoret per larje sigurohet me pus shpimi ne sheshin brenda territorit te linjes.

### **Shkarkime te ngurta**

Mbetje teknologjike fraksion i imet nga linja e inerteve qe varion 1- 5 % e sasise se lendes se pare te perpunuar, mase e cila kalon me ujerat. Kjo mase pas dekantimit sistemohet dhe riperdoret nga zona.Mbetje me fraksion mbi 20 mm e linje se fraksionimit, e cila perdoret per mbushje dhe rilevime.

### **Shkarkimet e lengeta**

Ujerat industrial qe perdoren ne linjen e fraksionimit, orientohen me nje kanal siperfaqesor ne sistemin e vecante. Meqenese masa e perdorur eshte inerte, keto ujera nuk permbajne elemente qe mund te kontaminojne ujerat. Megjithate jane ndertuar gropa paradekantuese te mases se ngurte per te evituar derdhjet e mbetjeve te ngurta ne mjedisin ujqor prites.

### **Shkarkimet e gazta**

Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere, por vetem pluhur. Per te minimizuar kete ndikim negativ eshte ber nje izolim ne pjesen e daljes se mases se bluar per ne transportier, me nje skelet dhe dok te gomuar ne menyre qe pluhurat te mos perhapen ne menyre kaotike, sidomos ne kohe te thate dhe me ere. Ne raste te tilla subjekti perdore sperkatjen me uje here pas here ndersa makinat transportuese jane te mbuluara. Gazet prej mjeteve te punes jane ne intervale kohore te shkurtra , brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth.

### **Zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim- shkarkimit, sitat vibruese dhe mulliri . Keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune 8 ore , megjithate shoqeria ka pajisur punetoret me mjete mbrojtese ndaj saj.

Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej linjes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth.

### **Mbetjet e ngurta**

Mbeturinat e ngurta vijne nga:

Aktiviteti human, mbetje urbane te plastikes, qelqit, metaleve etj te cilat jane te riciklueshme dhe do te hidhen ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones.

Nga aktiviteti vleresohet te kete mbetje te ngurta nga ambalazhet e produktit, si plastmas, leter, karton paleta druri. Persa i perkete materialit te demtuar, ai mund te rifutet ne procesin e fabikes dhe te ripaketohet, ndersa ambalazhet e tyre, hidhen ne kontenieret e mbetjeve te ngurta te zones.

### **Ndotja e tokes**

Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem; Sistemi i transportimit dhe ngarkim shkarkimit eshte i mbyllur dhe mundesite e derdhjeve ne mjedis te lendes gjate procesit nuk egzistojne. Sistemi i terminalit te shkarkimit eshte i pa shtruar me beton ose me asfaltobeton, si rrjedhoje mund te kete ndotjke te tokes, ne raste te derdhjes se lendes se bitumit ne mjedis. Kamionet jane veteshkarkues dhe materiali i granilit terhiqet vete nga sistemi i silloses se makinerise. Minimizimi i ndikimit ne mjedis lidhet me shkallen e trajnimit dhe ndergjegjesimit te punonjesve te kompanise per te mos lejuar furnizuesit apo cdo firme kontraktuese qe siguron furnizimin me lende te pare, te shkaktoje shkarkim te lendes se pare ne toke. Gjithashtu siperfaqja e tokes ku automjetet kryejne ngarkimin dhe shkarkimin e lendes se pare dhe produktit nuk eshte e betonuar dhe ekziston mundesia e ndotjes se tokes nga shkarkimet ne mjedis. Automjetet dhe makinerite duhet te jene te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te Automjeteve. Mundesia e ndotjes nga rrjedhjet eshte pothuajse zero. Automjeteve duhet tu kryhet pastrimi ne menyre periodike per te mos mbartuar bitum ose papasterti te tjera gjate transportit ne zonat urbane dhe me rruge te asfaltuara. Shkarkimi ne toke i elementeve te demshem per mjedisin, shkakton ndotje serioze ne mjedis, ndaj rekomandohet qe aktivitetet te jene te paisura me masa mbrojtese dhe te shtrojnë siperfaqet ku ato veprojnë. Ndotja e tokes, ndikon edhe ne ndotjen e ujerave nentokesore.

### **Ndotja e ajrit**

Ndotja e ajrit vjen nga pluhuri i granilit dhe reres te ekspozuara ne ambiente te hapura, si dhe nga aktiviteti i ngarkimit e shkarkimit te materialit.

Procesi punes se impiantit perfshin procese te perdorimit te lendes djegese dhe ka procese shkrirje qe mund te shoqerohet me clirime te gazeve te demshme per mjedisin. Persa i perkete zhurmave, ato jane te ndjeshme vetem brenda ambienteve te fabrikes dhe nuk jane problem per mjediset e jashteme dhe fqinjët. Kaldaja e ngrohjes se bitumit mund te funksionojë me solar ose me system gaz i lengshem i naftes.

### **Shkarkimet ne ujera**

Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- Pastrimi i ambientit ne rast te shkarkimit te materialit te gurit gelqeror nga avari te ndryshme, kryesisht nga nderprerja e punes per shkak te nderprerjeve te energjise elektrike
- Ne rastet e pastrimit te automjeteve te transportit ne ambientin e kantierit.
- Ujerat e pastrimit te ambientit te parkimit te makinerive dhe paisjeve te renda.
- Ujerat e perodur per pastrimin e cisternave te depozitimit te bitumit.
- Ujerat e perdorura per qellime sanitare.

Lidhur me ujerat qe vijne nga perdorimi sanitar, ato nuk duhet te perzihen me ujrata industriale, por duhet te kalojne ne sistem kanalizimi dhe te lidhen me kolektorin e zones. Gjithashtu ujerat industriale, mbas proceseve te ndarjes ne dekantim duhet te kalojne ne sistem te mbyllur me riqarkullim, ose pas dekantimit te tyre nga lenda e ngurte ne pezulli, mund te shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Nuk duhet te shkarkohen ne lum, ne gjendjen fillestare te tyre, pa

kaluar ne sistem trajtimi.Nuk duhet te shkarkohen ne mjedisin ujqor te zones pa u trajtuar paraprakisht. Ndikimi i ketij aktiviteti ne ujera konsiston ne ujerat e pastrimit te ambientit te punes

## KUADRI INSTITUCIONAL PËR MBROJTJEN DHE MENAXHIMIN E MJEDISIT

### Menaxhimi i Mjedisit

Historia institucionale e mbrojtjes së mjedisit në Shqipëri daton që në vitin 1991 kur pranë Ministrisë së Mjedisit u krijua Komiteti i Mbrojtjes dhe Ruajtjes së Mjedisit. Në vitin 1998, Kuvendi i Shqipërisë e shndërroi Komitetin në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, një institucion i pavarur që përgjigjet drejtpërdrejt para Kryeministrit. Ministria e parë e Mjedisit u krijua më 21 shtator 2001. Kjo ishte në vazhden e prirjes drejt dhënies së një rëndësie dhe autoriteti më të madh mbrojtjes së mjedisit. Në vitin 2005, kjo Ministri u shndërrua në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU).

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, përgjegjësitë kryesore të MMPAU- së janë:

- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatat publike dhe jofitimprurëse, rritja e nivelit të kontrollit të zbatueshmërisë së legjislacionit mjedisor.
- Përgatitja e draft-projekteve, protokolleve të konventave, projekteve dhe programeve që realizohen në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare mjedisore, si edhe ndjekjen e zbatimit të tyre.
- Studimin e nevojave të vendit për specialistë dhe bashkërendimi i veprimtarive të kualifikimit dhe specializimit të personelit që punon në fushën e mbrojtjes së mjedisit.
- Mbështetja e projekteve të kërkimit shkencor për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, futjen e teknologjive të pastra dhe promovimin e veprimtarive të organizatave jofitimprurëse, dhe
- Mbështetjen e organeve të qeverisjes vendore në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe në përgatitjen e planeve mjedisore lokale të veprimit.

Ministria ka krijuar Drejtori të veçanta për politika specifike. Struktura e re ka rritur përgjegjësitë e saj dhe ka zgjeruar fokusin e saj në drejtim të forcimit të zbatimit të ligjit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, integritetit mjedisor dhe harmonizimit të kuadrit ligjor mjedisor me standardet e BE-së.Përgjegjësitë e Agjenci Rajonale Mjedisore janë zbatimi dhe kontrolli i zbatueshmërisë së legjislacionit; kryerja e inspektimeve në terren; kontrolli i impianteve ekzistuese dhe përdorimi i burimeve natyrore brenda rajoneve të tyre; pjesëmarrja në dhënien e lejeve mjedisore për veprimtaritë e reja dhe mbështetja e monitorimit dhe vlerësimeve mjedisore.

## Menaxhimi i Ujërave

Sipas Ligjit për Burimet Ujore të vitit 1996, menaxhimi i burimeve ujore i është ngarkuar Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU, d.m.th ish-Autoritetit të Ujit) dhe Sekretariatit Teknik të tij (organit zbatues) në nivel qendror dhe Autoriteteve të Baseneve Ujore në nivel vendor. KKU-ja është krijuar si një organ i një niveli shumë të lartë për të siguruar që të ketë pushtet politik të mjaftueshëm. Këshilli Kombëtar i Ujit kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërjen e tij përfaqësues nga disa ministri (Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Ekonomisë, Telekomunikacioneve dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Rregullimit të Territorit Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Brendshme). Në vitin 1998, KKU-ja përcaktoi kufijtë e gjashtë baseneve lumore (Baseneve të Drin-Bunës, Ishëm-Erzenit, Shkumbinit, Semanit dhe Vjosës) dhe dy vjet më vonë, në bazë të një vendimi u krijua Këshilli i Basenit Ujor dhe Agjencia zbatuese për secilin nga këta gjashtë basene. Në fillim të vitit 2001, një vendim i KKU-së përcaktoi përgjegjësitë e Këshillave të mëparshme të Baseneve të Ujit dhe Agjencive të Ujit në lidhje me dhënien e lejeve të nxjerrjes sipas kategorisë (llojit) të aplikantit/kërkuesit dhe sasisë së kërkuar. Që në vitin 1998, Agjencia Kombëtare e Mjedisit është përgjegjëse për përcaktimin e standardeve të cilësisë së ujit dhe kufijve të shkarkimeve të ujit në bashkërendim me ministri të tjera. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ujit dhe monitorimin e shkarkimeve, si edhe për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave në lidhje me gjendjen e mjedisit, duke përfshirë masat ujore në nivel vendor dhe rajonal.

## Institucione të Tjera të Përfshira

Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet Institutit të Higjienës dhe Epidemiologjisë dhe Inspektoratit Shtetëror të Shëndetësisë, është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Drejtoritë vendore të shëndetit publik realizojnë kontrollin dhe monitorimin në nivelin vendor.

Ministria e Punëve Publike dhe Rregullimit të Territorit planifikon dhe menaxhon infrastrukturën e furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujit dhe garanton mbështetje të specializuar teknike. Furnizimi me ujë organizohet sipas rretheve, ku secili ka të paktën një ndërmarrje ujësjellësi.

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, nëpërmjet Drejtorisë së saj Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit, ka qenë tradicionalisht përgjegjëse për administrimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit. Aktualisht, ky menaxhim po i kalon gradualisht shoqatave të përdoruesve të ujit. Komisioni i Përhershëm i Shëndetësisë dhe Mjedisit punon për Parlamentin dhe rishikon projektligjet e hartuara nga MMPAU, miraton marrëveshjet ndërkombëtare mjedisore dhe akte të tjera ligjore në lidhje me çështjet mjedisore. Mandati i tij përcaktohet nga Parlamenti dhe anëtarët



e tij janë përfaqësues nga të gjitha grupet parlamentare. Komisioni rishikon dhe përgatit aktet ligjore që do të miratohen nga parlamenti. Ai ka të drejtë të mbikëqyrë veprimtaritë e MMPAU-së rast pas rasti kur ka një interes të veçantë publik. Veçanërisht i rëndësishëm është Këshilli Ndërmintor i Rregullimit të Territorit të Shqipërisë. Aipërbëhet nga Kryeministri dhe përfaqësues të MMPAU-t dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve (Departamenti i saj i Planifikimit dhe Zhvillimit Urban luan rolin e Sekretariatit të Këshillit) dhe nga përfaqësues të ministrive të tjera. Një numër ministrish dhe institucionesh kanë marrë përsipër detyra të rëndësishme për mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit. Disa nga këto Ministri kanë njësi të veçanta mjedisore.

#### Organizimi në Nivelin Lokal dhe Rajonal

Në nivelin rajonal ekzistojnë programe/marrëveshje për mbrojtjen e mjedisit ndërmjet Agjencive Rajonale Mjedisore, inspektorateve rajonale të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Inspektorateve të Shëndetësisë të Ministrisë së Shëndetësisë. Në nivelin lokal, bashkitë janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, ndonëse ato, me përjashtim të një numri të vogël bashkish, nuk janë të pajisura me njësi të specializuara mjedisore. Sipas Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore, autoritetet vendore kanë përgjegjësi për menaxhimin e ujësjellësve/ furnizimit me ujë, mbetjeve urbane, infrastrukturën e transportit dhe zonat e gjelbra urbane. Para miratimit të këtij Ligji, bashkitë kishin shumë pak autonomi. Ky Ligj i ri parashikon decentralizimin e kompetencave nëpërmjet delegimit të të drejtave dhe detyrimeve nga qeveria qendrore tek ajo vendore. Qeveria ka vendosur gjithashtu hartimin e planeve lokale mjedisore të veprimit në vijim të Planit Kombëtar Mjedisor të Veprimit. Planet Lokale Mjedisore të Veprimit do të parashikojnë vlerësimin në mjedis në nivelin lokal, identifikimin e prioritetëve, hartimin e programeve të trajnimit, si dhe zhvillimin e partneriteteve me OJQ/OJF-të.

#### Organizatat joqeveritare/jofitimprurëse.

Shumë nga OJQ-të janë më tepër shoqata profesionistësh sesa grupe veprimi

Organizatat mjedisore shqiptare kanë ndërmarrë veprimtari në fushat e mëposhtme:

- Mbrojtja e biodiversitetit, vlerësimi i habitateve, depozitimi i mbetjeve të ngurta, studimi i problemeve të ndotjes urbane, etj.
- Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje, diskutime në tryeza të rrumbullakëta, nënshkrime rezolutash etj.

- Edukimi mjedisor i komunitetit nëpërmjet seminareve dhe trajnimeve, programeve të medias, publikimit të materialeve të ndryshme, veprimtarive që synojnë grupmoshat e nxënësve të shkollës dhe studentëve etj.

Në përmbushjen e objektivave të tyre, ato kanë synuar kryesisht sensibilizimin e opinionit publik. Përfshirja e publikut është realizuar kryesisht në formën e nënshkrimit të disa rezolutave të cilat u drejtohen strukturave të qeverisjes vendore apo asaj qendrore.

## LEGJISLACIONI DHE POLITIKAT MJEDISORE

### Hyrje

Zhvillimi një sistemi ligjor modern për mbrojtjen e mjedisit filloi në vitin 1991. Pavarësisht nga të gjitha përpjekjet e bëra në drejtim të përmirësimit të sistemit ligjor mjedisor, ka ende mangësi, veçanërisht në aspektet e mbrojtjes së natyrës, si dhe të diversitetit biologjik dhe të peizazhit. Sistemi ligjor aktual është në përmirësim të vazhdueshëm. Qeveria po i kushton vëmendje të veçantë harmonizimit të ligjeve shqiptare me ato të Bashkimit Evropian (BE). Kushtetuta, e miratuar në vitin 1998, kërkon nga autoritetet shqiptare të ruajnë një mjedis të shëndetshëm, ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tanishëm dhe ata të ardhshëm. Për ta arritur këtë, Qeveria duhet të përmirësojë më tej dhe të plotësojë kuadrin ligjor dhe institucional që mbulon mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe biodiversitetit.


